



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**V E N D I M**

**NR. 17 / 2, DATË 01 / 02 / 2023**

**PËR**

**MOSPANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "AQUATIQ" SH.P.K. PËR  
NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE  
NR. 17 DATË 18.07.2022 DHE VËNIEN NË DISPOZICION TË PARCELAVE OBJEKT I  
SAJ PËR REALIZIMIN NË TËRËSI TË INVESTIMIT STRATEGJIK TË "FERMËS  
AKUAPONIKE" NGA SUBJEKTI "AQUATIQ" SH.P.K."**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 55/2015, "Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Komiteti i Investimeve Strategjike,

**KONSTATOI SE:**

- Komiteti i Investimeve Strategjike, me Vendimin Nr. 17 datë 18/07/2022 "Për transferimin e parcelave të lira, pronë shtetërore, në zonën DJ-B\_B\_1, në Zonën Kadastrale Nr. 2085, Karavasta e Re, Bashkia Divjakë, në fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike", ka vendosur:

*Transferimin dhe përfshirjen e pronës së paluajtshme shtetërore në zonën kadastrale nr. 2085, Karavasta e Re, Bashkia Divjakë, kategoria e resursit "arë", me vendndodhje dhe sipërfaqe sipas Aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, me institucion administrues Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS).*

- Me shkresën nr. 17/1 prot. datë 5.12.2022, subjekti investues ka kërkuar ndryshimin e Vendimit të KIS nr. 17 datë 18.7.2022 dhe vënin në dispozicion të parcelave objekt i saj për realizimin në tërësi të investimit strategjik të Fermës Akuoponike, nga subjekti "Aquatiq". Sh.p.k..

Komiteti i Investimeve Strategjike, duke pasur parasysh të gjithë historikun e shqyrtimeve dhe miratimit të projektit të investimit në fjalë, si dhe komunikimet e subjektit investues në lidhje me të, konkludon se Vendimi nr. 17 datë 18.07.2022 është një vendim i marrë në respektim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, në përputhje të plotë me vullnetin dhe strategjinë institucionale dhe në respektim të plotë të parimit të ligjshmërisë, të mvetësisë dhe të diskrecionit për të disponuar ndërmjet alternativave apo mundësive, atë që vlerësohet si më oportune.

Për sa më sipër,

## **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë "Aquatiq" sh.p.k. për ndryshimin e Vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike nr. 17 datë 18.07.2022 dhe vënien në dispozicion të parcelave objekt i saj për realizimin në tërësi të investimit strategjik të "Fermës Akuoponike" nga subjekti "Aquatiq" sh.p.k..
2. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për njoftimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KRYETARI I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

### **ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

### **MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

**BELINDA BALLUKU**

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**

DELINA IBRAHIMAJ

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

MIRELA KUMBARO

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

FRIDA KRIFCA

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**

ODISE MOÇKA

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS**

SOKOL NANO